

RAPORT PËR LIRITË FETARE NDËRKOMBËTARE NË KOSOVË PËR VITIN 2017

Përmbledhje ekzekutive

Kushtetuta ndalon diskriminimin fetar dhe parashikon liri fetare që u nënshtrohen kufizimeve për të siguruar rend publik, shëndet dhe siguri ose për t'i mbrojtur të drejtat e të tjerëve. Ligji nuk i lejon grupet fetare të regjistrohen si subjekte ligjore, duke krijuar kështu pengesa për ta në përmbushjen e detyrave të veta. Parlamenti e shqyrtoi një projektligj që do ta lejonte regjistrimin e grupeve fetare si subjekte ligjore në mënyrë që ato të mund t'i kryenin punët dhe çështjet ligjore me subjektet shtetërore dhe private. Parlamenti e miratoi projektligjin në leximin e parë më 29 nëntor dhe priste ta mbante leximin përfundimtar në fillim të 2018-ës. Grupet fetare thanë që autoritetet komunale shpesh nuk u siguronin të drejta dhe përfitime të barabarta, posaçërisht lidhur me pronën fetare dhe vendet e varrimit. Komuna e Prishtinës, duke cituar mungesën e lejes për ndërtim, vazhdoi t'ua ndalonte murgjive ortodoksë serbë që ta pastronin dhe të bënin riparime të lehta në kishën e papërfunduar të Krishtit Shpëtimtar pasi vandalët ia kishin vënë zjarrin në vitin 2016. Kisha Ortodokse Serbe (KOS) tha se ish-Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Kujtim Shala, nuk e përmbushi një premtim për ta lëshuar një leje për rindërtimin e një kisha në Manastirin e Shën Arkangjelit në Prizren. Pasardhësi i tij, Kujtim Gashi, u zotua ta shqyrtojë këtë çështje sipas ligjit. Kryetari i Deçanit, Rasim Selmanaj, refuzoi ta zbatonte një vendim të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2016, me të cilin 24 hektarë tokë të kontestuar rreth Manastirit të Deçanit i jepeshin KOS-it; sistemi gjyqësor nuk kërkoi llogari prej tij. Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) raportoi për diskriminim social dhe në punësim kundër myslimanëve të devotshëm, posaçërisht në sektorin publik. Qeveria punoi me BIK-un për ta luftuar ekstremizmin e dhunshëm dhe e dënoi vandalizimin e vendeve fetare.

Protestuesit i sulmuan pjesëmarrësit në disa ndodhi të pelegrinëve ortodoksë serbë. Në një incident, protestuesit e gjuajtën me gurë dhe e ngjyrosën me ngjyrë të kuqe një autobus që bartte pelegrinë për në kishën e KOS-it në Gjakovë, duke dëmtuar një dritare dhe shkruan me sprej fjalën “vrasës” në murin e jashtëm të kishës. Në disa raste, vandalë të paidentifikuar i dëmtuan pronat fetare të KOS-it, përkundër mbrojtjes nga qeveria. Një serb e dëmtoi një xhami në komunën e Parteshit; KOS-i e dënoi këtë incident. Organizatat fetare u takuan rregullisht për t'i diskutuar të drejtat pronësore, prioritetet legjislative dhe çështjet e bashkësisë lokale.

Ambasadori dhe përfaqësues të Ambasadës së SHBA-së shpesh u takuan me zyrtarë qeveritarë për ta nxitur tolerancën fetare, miratimin e legjislacionit për t'u lejuar institucioneve fetare që të fitonin status ligjor dhe zbatimin e plotë të ligjit për mbrojtjen e objekteve fetare dhe për t'i diskutuar përpjekjet për zgjidhjen e kontesteve të pronave fetare. Ambasada e mbrojti rregullisht dhe në të gjitha nivelet e qeverisë zbatimin e plotë të vendimeve gjyqësore në dobi të bashkësive fetare të pakicave. Ambasada dekurajon zyrtarët publikë, institucionet arsimore dhe subjektet e tjera nga angazhimi në praktika diskriminuese të punësimit ndaj myslimanëve të devotshëm ose grupeve të tjera fetare. Zyrtarët e Ambasadës rregullisht diskutuan tolerancën fetare me udhëheqësit e të gjitha bashkësive të mëdha fetare.

Seksioni I. Demografia fetare

Qeveria e SHBA-së vlerëson se numri i përgjithshëm i popullsisë është 1,9 milionë banorë (vlerësim i korrikut të vitit 2017). Të dhënat e regjistrimit nga viti 2011 tregojnë se 95,6 për qind e popullsisë identifikohen si myslimanë, 2,2 për qind si katolikë romanë dhe 1,4 për qind si serbë ortodoksë. Sipas KOS-it, bojkotimi i regjistrimit nga ana e serbëve rezultoi në llogaritje shumë më të ulët të anëtarëve të KOS-it. KOS-i vlerëson se në Kosovë ka 120.000 besimtarë ortodoksë serbë, ose 6,3 për qind. Bashkësitë e tjera fetare, përfshirë tarikatet dhe protestantët, gjithashtu i kontestojnë të dhënat e regjistrimit të përgjithshëm. Udhëheqësit protestantë dhe ata pa përkatësi fetare thanë se padrejtësisht disa anëtarë të bashkësive të tyre ishin klasifikuar gabimisht si myslimanë nga personat që bënë regjistrimin e përgjithshëm. Bashkësia protestante vlerëson se në tërë vendin ka 20.000 ndjekës, ose 1,1 për qind të popullsisë. Kategoritë e regjistrimit për “Tjetër”, “Asnjë”, ose “S’ka përgjigje” përbëjnë secila më pak se 1 për qind.

Pjesa më e madhe e popullatës myslimane i takon shkollës Hanafi Suni, ndonëse një numër i tyre i ndjekin traditat Sufi ose Shia dhe janë pjesë e grupeve e shkollës tarikat ose të urdhrit bektashi. Udhëheqësit e tarikateve theksojnë se bektashianët janë njëri prej nëntë urdhrave të tarikatit, por bektashianët e identifikojnë veten si urdhër i veçantë islamik.

Shumica e anëtarëve të KOS-it jetojnë në komunat me shumicë serbe në pjesën jugore të vendit ose në katër komunat veriore me shumicë serbe. Bashkësitë më të mëdha katolike janë në Gjakovë, Janjevë, Klinë, Prishtinë dhe Prizren. Popullatat protestante ungjillore gjenden në tërë vendin dhe janë të përqendruara në Prishtinë dhe Gjakovë. Një numër i vogël i hebrenjve jeton në Prizren dhe Prishtinë.

Feja dhe përkatësia etnike janë shpesh të lidhura. Pjesa më e madhe e shqiptarëve janë myslimanë, ndërsa disa janë katolikë dhe protestantë; pothuaj të gjithë serbët i përkasin KOS-it. Pjesa më e madhe e ashkalinjve, boshnjakëve, egjiptianëve, goranëve, romëve dhe turqve gjithashtu janë myslimanë, ndërsa pjesa më e madhe e malazezëve dhe disa romë i përkasin KOS-it. Pothuaj të gjithë kroatët i përkasin kishës katolike.

Seksioni II. Statusi i respektimit të lirisë fetare nga Qeveria

Korniza ligjore

Kushtetuta parashikon të drejtën e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë për të gjithë qytetarët, përfshirë të drejtën për ta ndërruar, shprehur apo për të mos e shprehur besimin fetar, për ta ushtruar fenë apo për të mos e ushtruar fenë, dhe për t’iu bashkuar apo refuzuar për t’iu bashkuar një bashkësie fetare. Këto të drejta u nënshtrohen kufizimeve për shkak të sigurisë dhe rendit publik ose për ta mbrojtur shëndetin apo të drejtat e të tjerëve. Kushtetuta parashikon ndarjen e bashkësive fetare nga institucionet publike, përfshirë të drejtën e grupeve fetare për t’i rregulluar në mënyrë të pavarur organizimet, aktivitetet dhe ceremonitë e tyre, dhe të drejtën për të themeluar shkolla fetare dhe institucione bamirësie. Ajo garanton të drejta të barabarta për të gjitha bashkësitë fetare, përcakton që vendi është shtet laik dhe neutral lidhur me fenë, deklaron që shteti do ta sigurojë mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë fetare të vendit dhe ndalon diskriminimin e bazuar në fe. Kushtetuta përcakton që ligji mund ta kufizojë lirinë e shprehjes për ta parandaluar provokimin e dhunës dhe armiqësisë për shkak të racës, nacionalitetit, përkatësisë etnike apo fesë. Ajo u lejon gjykatave t’i ndalojnë organizimet apo aktivitetet që inkurajojnë urrejtje racore, nacionale, etnike apo fetare.

Kushtetuta përcakton që bashkësitë tradicionalisht të pranishme në vend, përfshirë bashkësitë fetare, të kenë të drejta specifike, përfshirë mbajtjen, zhvillimin dhe ruajtjen e fesë e tyre, përdorimin e gjuhës së tyre, themelimin dhe menaxhimin e shkollave të tyre private me ndihmë financiare nga shteti, dhe qasje në mediat publike. Në të drejta shtesë përfshihen themelimi dhe përdorimi i mediave të veta, mbajtja e kontakteve të papenguara e paqësore me persona jashtë vendit me të cilët ndajnë identitetet fetar dhe qasje të barabartë në punësim publik. Ajo ua garanton bashkësive pakicë 20 prej 120 ulëseve në kuvendin nacional. Ajo gjithashtu përcakton që miratimi, ndryshimi ose shfuqizimi i cilitdo ligj që ka të bëjë me lirinë fetare dhe trashëgiminë kulturore ose për marrëveshjet me bashkësitë fetare kërkon shumicën e deputetëve që i përfaqësojnë bashkësitë pakicë, si dhe shumicën e të gjithë deputetëve.

Kushtetuta parashikon Institucionin e Avokatit të Popullit, i cili është përgjegjës për monitorimin e lirisë fetare, ndër të drejta të tjera të njeriut, dhe për rekomandim të veprimeve për t'i korrigjuar shkeljet. Ajo përcakton që shteti do t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për t'i mbrojtur individët që mund të jenë subjekt i kërcënimit, armiqësisë, diskriminimit apo dhunës për shkak të identitetit të tyre fetar.

Ligji nuk parashikon mekanizëm ligjor apo udhëzim specifik që grupet fetare të fitojnë status ligjor përmes regjistrimit apo mënyrave të tjera. Ligji nuk kërkon që grupet të regjistrohen, por pa status ligjor, grupet fetare nuk mund të posedojnë pronë, të hapin llogari bankare, të punësojnë personel, të kenë qasje në gjykata apo të kryejnë punë të tjera administrative në emër të tyre.

Ligji përcakton që nuk ka fe zyrtare, por i cek pesë bashkësi "tradicionale" fetare: BIK-un, KOS-in, kishën katolike, bashkësinë hebraike dhe kishën (protestante) ungjillore. Ligji parashikon mbrojtje dhe përfitime shtesë për këto pesë grupe, si uljen e taksave dhe lirim nga pagesa e ujit. Sipas ligjit, ndërtesat fetare që u përkasin këtyre pesë bashkësive, por jo edhe zyrat e tyre administrative, kanë të drejtë në heqjen e pagesave për shërbime të ujit. Institucionet fetare duhet të paraqesin kërkesë pranë furnizuesit publik të ujit në mënyrë që të lirohen nga pagesa.

Ligji parashikon mbrojtje për zonat e veçanta të mbrojtura fetare e kulturore (ZVM) në bazë të rëndësisë fetare e kulturore duke i kufizuar aktivitetet në afërsi që mund ta dëmtojnë mjedisin e tyre historik, kulturor apo natyror. Sipas ligjit, Këshilli për Zbatim dhe Monitorim (KZM) gjykon kontestet mes qeverisë dhe KOS-it lidhur me ZVM-të dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e trashëgimisë fetare e kulturore të KOS-it. KZM-ja është organ i posaçëm që rrjedh nga Plani Gjithëpërfshirës për Kosovën dhe Ligji për ZVM-të. Ai filloi punën në vitin 2010. Mandati i tij përfshin mbrojtjen e trashëgimisë së KOS-it, siç përfshihet në Ligjin për fshatin Hoçë e Madhe dhe në Ligjin për qendrën historike të Prizrenit. KZM përfshin Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) (si bashkëkryesuese), MKRS-në, KOS-in, Përfaqësuesin Special të Bashkimit Evropian (si bashkëkryesues) dhe Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

Komunat janë titullarë të të gjitha varrezave publike, përfshirë ato të bashkësive fetare, dhe, sipas ligjit, ato duhet të kujdesen për mirëmbajtjen e tyre.

Sipas ligjit, "institucionet e arsimit publik duhet të përmbahen nga mësimdhënia fetare apo aktivitete të tjera që përhapin fe specifike".

Vendi nuk është palë e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike.

Praktikat qeveritare

Paragraf përmbledhës: Qeveria ndërmori masa për t'iu kundërvënë radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm që lidhet me fenë. Në shkurt, Prokuroria Speciale (PSRK) ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore të Prishtinës kundër Shefqet Krasniqit, ish-krye imam i Xhamisë së Madhe në Prishtinë, për nxitje të terrorizmit. Parlamenti e shqyrtoi një projektligj të rekomanduar nga qeveria, që do t'u lejonte grupeve fetare të regjistroheshin dhe të fitonin status ligjor në mënyrë që të mund t'i kryenin punët e veta. Parlamenti e miratoi ligjin në lexim të parë më 29 nëntor dhe priste që leximin e dytë ta mbante në fillim të 2018-ës. Disa zyrtarë të shkollave zbatuan një udhëzim administrativ të detyrueshëm me të cilin u ndalonin nxënëseve veshjen e rrobave fetare në pronën e shkollës. Sipas disa bashkësive fetare, qeveria vazhdoi t'i përgjigjej dhunës shoqërore dhe vandalizmit kundër disa bashkësive fetare pakicë. Megjithatë, pakicat fetare, posaçërisht protestantët, thanë që komunat dështuan të vepronin sipas kërkesave për ndërtim të kishave dhe varrezave dhe për t'u ndihmuar atyre me çështje të ndarjes së zonave. Disa konteste të kahershme lidhur me pronësinë e pronës fetare mbetën të pazgjidhura. Njësia e policisë për mbrojtje të objekteve të trashëgimisë kulturore e fetare vazhdoi të ofronte siguri në objektet fetare e kulturore anembanë vendit; megjithatë, vjedhjet dhe vandalizmi vazhduan në disa objekte të KOS-it. Qeveria vazhdoi të ofronte pak financim për edukatën islame në medresetë e BIK-ut; ajo nuk e financoi edukatën fetare për asnjë grup tjetër fetar. Shumica e serbëve që mësimin e vijonin në shkollat publike në gjuhën serbe zgjodhën të regjistroheshin në orë të edukatës fetare ortodokse serbe. Qeveria e Serbisë i financonte pagat e të gjithë mësimdhënësve në shkollat në gjuhën serbe, përfshirë instruktorët fetarë, dhe Qeveria e Kosovës i plotësoi pagat e disa mësimdhënësve dhe të stafit në këto shkolla. BIK-u raportoi për incidente të diskriminimit të myslimanëve të devotshëm në punësim, posaçërisht në sektorin e arsimit, duke cituar përjashtimin, në muajin mars, nga puna të një mësimdhënëseje në një shkollë publike të Prizrenit, e cila refuzoi ta hiqte shaminë në vend të punës. Udhëheqës të bashkësisë myslimane raportuan për praktika diskriminuese në punësim në qeveri; duke theksuar që kandidatët për punësim në shërbim civil nganjëherë refuzoheshin për shkak të besimit fetar. Qeveria vazhdoi me programin e vet Interfaith Kosova, dhe zyrtarë e përfaqësues nga të gjitha bashkësitë kryesore fetare morën pjesë në shenjterimin e katedrales katolike Shën Tereza në Prishtinë.

Më 27 shkurt, PSRK ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore të Prishtinës kundër Shefqet Krasniqit, ish-krye imam i Xhamisë së Madhe në Prishtinë. PSRK e akuzonte Krasniqin për nxitje të terrorizmit dhe përhapje të jotolerancës nacionale, racore dhe fetare. Sipas një kumtese të lëshuar nga PSRK-ja, Krasniqi përdorte predikimet e tij dhe mediat sociale për t'i nxitur individët që të udhëtonin në zona të konfliktit në Siri dhe Irak dhe për të kryer akte të terrorit. Krasniqi fillimisht u arrestua në vitin 2014 dhe u përjashtua nga Xhamia e Madhe në vitin 2015. Përkundër përjashtimit të tij nga Xhamia e Madhe, Krasniqi vazhdoi t'i predikonte porositë e tij në TV, radio dhe media sociale.

Në dhjetor, Gjykata Themelore e Prishtinës dëgjoi dëshminë e katër imamëve, dy të akuzuar për kryerje të akteve terroriste dhe dy të akuzuar për “nxitje të urrejtjes nacionale, racore fetare ose etnike”. Vëzhguesit e mediave pritën një aktvendim në vitin 2018.

Udhëheqësit fetarë vazhduan ta përkrahnin miratimin e një projektligji që do të siguronte një mekanizëm ligjor përmes të cilit grupet fetare do të mund të fitonin status ligjor. Kjo do t'u

mundësonte të kryenin punë dhe çështje ligjore me subjektet shtetërore e private. Bashkësia bektashi gjithashtu kërkoi që ligji të cekte se ajo është një bashkësi që është pjesë përbërëse e trashëgimisë historike dhe e jetës kulturore dhe sociale në vend. Ndonëse përfaqësuesit e shumë grupeve fetare thanë se kishin gjetur mënyra alternative për të kryer punët e tyre, shumica prej tyre raportuan për vështirësi në regjistrimin e pronës dhe të automjeteve, në hapjen e llogarive bankare dhe në pagimin e tatimit për të ardhurat e punëtorëve. Disa bashkësi fetare hapën llogari bankare që nuk ishin në emër të bashkësisë së tyre dhe Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës mori numrin fiskal nga qeveria për t'i paguar tatimet sikur të ishte biznes. Disa bashkësi thanë se ishte vështirë të ndërmerrnin detyra themelore financiare dhe t'atoheshin si biznese fitimprurëse.

Disa zyrtarë të shkollave vazhduan ta zbatonin një udhëzim administrativ të lëshuar më herët nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që ua ndalon nxënësve të shkollave fillore e të mesme veshjen e rrobave fetare në pronën e shkollës. Sipas BIK-ut dhe udhëheqësve të bashkësive të tjera myslimane, shkollat publike nganjëherë i dërgonin në shtëpi nxënëset që ngulnin këmbë në veshjen e shamisë gjersa e vijonin mësimin. Anëtarë të BIK-ut raportuan se disa shkolla publike i detyronin vajzat t'i hiqnin shamitë për të studiuar në këto shkolla. Institucioni i Avokatit të Popullit nuk pranoi asnjë raport që shkollat ua kishin ndaluar vijimin e mësimin nxënësve që vishnin rroba fetare, si shamitë.

Në dhjetor, Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) ia pagoi KOS-it qiranë për shfrytëzim të ndërtesës dhe parkingut të KOS-it në Prishtinë. Kjo i dha fund një zvarritjeje 6-vjeçare gjatë të cilës AKK-ja kishte refuzuar ta zbatonte vendimin e kryeministrit me të cilin urdhërohej pagesa e qirasë.

Grupet fetare përsëri thanë që autoritetet qeveritare nuk ndërmorën masa për të siguruar që komunitat do t'i trajtonin njëllëj organizatat fetare në çështje pronësore, posaçërisht në lidhje me kisha e varreza. Ndonëse ligji përcaktonte që komunitat ishin titullarë të varrezave dhe ishin përgjegjës për mirëmbajtjen e tyre, në praktikë, disa komuna u lejonin grupeve fetare të merrnin posedim *de facto* të varrezave publike.

Protestantët thanë që shumica e komunave nuk u kishin dhënë tokë për varreza dhe as që i kishin shqyrtuar kërkesat e tyre për të ndërtuar kisha në tokën në pronësi të bashkësisë. Komuna e Glllogocit i ndau tokë bashkësisë protestante për një varrezë dhe një kishë dhe bashkësia punonte me komunën për ta zbatuar vendimin.

Këshilli i qytetit të Prishtinës themeloi varrezën e parë në vend për anëtarë të Kishës Protestante Ungjillore të Kosovës (KPUK) më 24 prill. Votimi pohoi vendimin fillestar të këshillit, të 15 shkurtit, me të cilin lejohej varreza, të cilën MPMH-ja ishte përpjekur ta bllokonte mbi baza procedurale. Marrëveshja e kuvendit komunal përfshin sigurimin e pemëve dhe rrethojës në 6 hektarë të tokës publike afër varrezës hebraike të qytetit. Para këtij vendimi, disa mijëra anëtarë të KPUK-ut të qytetit ishin varrosur në varrezat komunale. Ndonëse subjekt publik, BIK-u jozyrtarisht i kontrollonte varrezat komunale. BIK-u nuk lejoi kryqë krishtere në varreza, u caktonte tarifë jomyslimanëve për shërbime të varrimit dhe në disa raste i bllokonte ritet krishtere të varrimit. Bashkësia katolike, ortodokse dhe krishtere e Prishtinës vazhduan të përdornin varreza të veçanta publike.

U raportua që varrezat ekzistuese hebraike ishin në gjendje të keqe. Anëtarët e bashkësisë hebraike thanë se u mungonin burimet për t'i mirëmbajtur varrezat hebraike dhe autoritetet lokale nuk i mirëmbanin këto vende publike siç kërkohet me ligj. Varreza ortodokse serbe në

Prishtinë gjithashtu ishte në gjendje të keqe dhe nuk mirëmbaheshin nga autoritetet komunale. KOS-i citoi zhvendosjen e anëtarëve nga zona si arsye për paaftësinë e saj për t'u kujdesur në mënyrë adekuate për varreza. Në të dy rastet, komuna e Prishtinës mohoi që këto varreza ishin në gjendje të keqe.

Ndonëse Kuvendi Komunal i Prishtinës u pajtua në nëntor të 2016-së që ta lëshonte një leje ndërtimi për Kishën Ungjillore Mesia për një shtëpi të adhurimit në tokën të cilën kisha e kishte blerë, MMPH-ja nuk e kishte lëshuar lejen përfundimtare deri në fund të vitit. Autoritetet komunale ia kishin mohuar lejen kishës për më tepër se një dekadë.

Nga fundi i vitit, qeveria ende nuk e kishte themeluar asociacionin e komunave me shumicë serbe, që duhej të vendoste për rindërtimin e një xhamie në Mitrovicën veriore. Udhëheqësit e BIK-ut vazhduan ta mbështetnin ndërtimin e xhamisë, të cilën forcat serbe e shkatërruan në vitin 1999.

Më 25 korrik, Kuvendi Komunal i Prishtinës ripohoi vlefshmërinë e lejes së vitit 2012 për ndërtimin e një "xhamie të madhe" në qytet. Ky vendim shfuqizoi ndalesën e vitit 2012 pas ankesave të qytetarëve se planet nuk përputheshin me estetikën ekzistuese të lagjes Dardania, siç kërkohet me rregulloret lokale. Në mbledhjen e korrikut, kuvendi e cilësoi vendimin e vitit 2015 si lexim të pavlefshëm të statutit lokal. Sipas planeve, kjo do të ishte xhamia më e madhe në Ballkan.

Në vitin 2016, komuna e Prishtinës miratoi kërkesën e OJQ-së Beit Izrael për të ofruar ndihmë në ndërtimin e një sinagoge. Megjithatë, deri më 20 tetor, komuna nuk kishte ofruar ndihmë dhe OJQ-ja Beit Izrael e kritikoi komunën për mospërbushje të kërkesës së miratuar.

Ndalesa e vitit 2016 e MKRS-së për leje për rindërtimin e kishës së Shën Nikollës në Manastirin e Shën Arkangjelit në Prizren mbeti në fuqi, ndonëse ministri i MKRS-së, Kujtim Gashi, ishte zotuar ta shqyrtonte këtë çështje sipas ligjit. Kisha e vetme e manastirit ishte shkatërruar në vitin 1999, dhe kisha e Shën Nikollës ishte shkatërruar në fund të shek. XVI. Sipas disa anëtarëve të KZM-së, refuzimi i ish-ministrit të MKRS-së, Kujtim Shala, për ta lëshuar lejen për rindërtim e shtyri KOS-in ta ndërpriste pjesëmarrjen në KZM. Ndonëse statuti i KZM-së bën thirrje për takime çdo dy muaj lidhur me ruajtjen e objekteve fetare e kulturore, ky grup nuk u takua zyrtarisht gjatë vitit. Për shkak të mungesës së lejes, inspektorët komunalë i urdhëruan KOS-it ta ndërpriste ndërtimin në disa raste në vitin 2016. KOS-i theksoi se mohimi i kërkesës nga Instituti erdhi pas një afati ligjor, pas të cilit ndërtimi do të duhej të ishte lejuar të vazhdonte automatikisht. Pavarësisht kërkesës, KOS-i kishte diskrecion të plotë për ta menaxhuar pronën e vet duke u bazuar në Aneksin V të Planit të Ahtisarit për Kosovën, i cili i mbulon çështjet fetare dhe kulturore.

Komuna e Prishtinës, duke cituar mungesën e lejes për ndërtim, vazhdoi t'ua ndalonte murgjve ortodoksë serbë që ta pastronin dhe të bënin riparime të lehta në kishën e papërfunduar të Shën Shpëtimtarit pasi vandalët ia kishin vënë zjarrin në vitin 2016. Zyrtarët e Prishtinës vazhdonin ta vinin në dyshim pronësinë e KOS-it për këtë pronë dhe marrja e lejes për ndërtim nevojitej për të ndërmarrë ndonjë punë brenda kishës, përfshirë ngjyrosjen mbi grafitë.

Zyrtarë të komunës së Deçanit vazhduan të refuzonin ta zbatonin vendimin e vitit 2016 të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, me të cilin konfirmohej aktvendimi i Gjykatës Supreme që

më tepër se 24 hektarë tokë duhej t'i ktheheshin Manastirit të Deçanit të KOS-it. Aktvendimi ligjërish i dha fund kontestit të KOS-it me një ndërmarrje inekzistente në pronësi shtetërore të kohës së Jugosllavisë dhe komunës së Deçanit. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese hodhi poshtë gjetjet e Kolegjit të Ankesave të Gjykatës Supreme të vitit 2015, që kërkonte kthimin e juridiksionit të këtij rasti në Gjykatën Themelore në Deçan. Kryetari i Deçanit, Rasim Selmanaj, vazhdoi gjatë tërë vitit ta quante vendimin të papranueshëm. Sistemi gjyqësor nuk kërkoi llogari nga ai apo zyrtarët e tjerë komunalë për moszbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Agjencia Kadastrale e Kosovës u pajtua ta dëgjojë një ankesë në këtë rast, për të cilin ekspertët ligjorë thanë se është e paligjshme pasi Gjykata Kushtetuese tashmë kishte nxjerrë një aktvendim. Trupat e KFOR-it italian vazhduan të ofrojnë siguri në manastir.

Më 30 qershor, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit i hoqi dy prona që i takonin manastirit të Deçanit nga lista e vet e ish-ndërmarrjeve shtetërore të parapara për privatizim. Vendimi ishte në përputhje me aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese me të cilin manastirit i konfirmohej pronësia e pronës.

Në nëntor, Gjykata e Apelit në Prishtinë mbështeti një vendim të një gjykate më të ulët për ta hedhur poshtë kërkesën e vitit 2012 të Universitetit të Prishtinës për ta anuluar një donacion të tokës të vitit 1991 për KOS-in nga qeveria serbe, që do të mundësonte rrënimin e kishës së Krishtit Shpëtimtar në kampusin universitar. Gjykata vendosi vetëm për procedurën, jo për meritat e ankesës. Universiteti paraqiti padi tjetër pak kohë pas aktvendimit të Gjykatës së Apelit.

Një ankesë nga komuna e Prishtinës kundër aktvendimit të vitit 2015 të Gjykatës Themelore që kisha katolike zotëronte pronë afër Katedrales Nëna Terezë mbeti i pazgjidhur në fund të vitit.

KOS-i shprehu shqetësim që MKRS-ja nuk u konsultua me të rreth një projektligji për trashëgiminë kulturore që ajo thoshte se do të mund ta anulonte autonominë e KOS-it të garantuar me ligj dhe do ta pengonte atë për të vendosur në mënyrë të pavarur për restaurimin dhe rinovimin e ndërtesave të veta. Në fund të vitit, MKRS-ja nuk e kishte përfunduar hartimin e ligjit. Në gusht, MKRS-ja kishte nxjerrë një udhëzim administrativ për të cilin KOS-i besonte se do të mund t'i komprometonte të drejtat pronësore të mbrojtura në Aneksin V të Planit të Ahtisarit.

Gjatë vitit, MKRS-ja përfundoi zhvillimin e strategjisë së re për trashëgimi kulturore për periudhën 2017-27. KOS-i tha se strategjia forconte bazën statutores për bashkëpunim mes qeverisë dhe KOS-it.

Njësia e policisë për mbrojtje të specializuar të objekteve të trashëgimisë kulturore e fetare vazhdoi të ofronte siguri 24-orëshe në 24 objekte anembanë vendit. Përkundër kësaj mbrojtjeje, vjedhjet dhe vandalizmi në objektet e KOS-it vazhduan, kryesisht jashtë ZVM-ve ku policia nuk ofronte mbrojtje të veçantë. Ministria e Kulturës tha se kishte kërkuar mbështetje shtesë nga qeveritë lokale për mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore. Megjithatë, sipas KOS-it dhe bashkësisë protestante, qeveritë lokale nganjëherë dështonin në përmbushjen e ligjeve ose të aktgjykimeve të gjykatave që i mbronin të drejtat e grupeve fetare.

Qeveria qendrore vazhdoi të siguronte pak financim për edukatën islame në medresetë e BIK-ut në Prishtinë, Prizren dhe Gjiilan. Disa anëtarë të grupeve të tjera fetare dhe përfaqësues

jofetarë thanë se ishin të shqetësuar sepse qeveria nuk siguronte financim për edukatën fetare për asnjë grup tjetër fetar.

Qeveria punoi me BIK-un dhe grupe të shoqërisë civile për ta luftuar ekstremizmin e dhunshëm. Si pjesë e strategjisë së qeverisë, BIK-u mbajti ligjërata në medresetë e veta dhe në fakultetet e studimeve islame, me ç'rast i nxiste nxënësit dhe studentët që të mos binin pre e ekstremizmit.

Serbët, goranët, kroatët dhe disa romë e vijonin mësimin në shkollat publike në gjuhën serbe që punonin me një program mësimor të hartuar nga qeveria e Serbisë, të bazuar në ligjet komunale për arsim dhe në koordinim me Ministrinë e Arsimit. Kufizimet për edukatën fetare nuk vlenin për këto shkolla publike. Shumica e serbëve zgjodhën të regjistroheshin në orë të edukatës fetare ortodokse serbe në vend të edukatës qytetare. Qeveria e Serbisë i financonte pagat e të gjithë mësimdhënësve në shkollat në gjuhën serbe, përfshirë instruktorët fetarë. Qeveria e Kosovës i plotësoi pagat e disa mësimdhënësve dhe stafit në shkollat në gjuhën serbe.

Mediat raportuan për trysni nga qeveria turke për t'i mbyllur shkollat që kishin lidhje me klerikun mysliman Fethullah Gulen, por qeveria refuzoi një gjë të tillë. Duke cituar mungesën e provave, qeveria refuzoi një kërkesë të qeverisë turke në tetor për ekstradimin e pasuesve të Gulenit mbi akuzat e lidhura me përpjekjet e vitit 2016 për grusht shtet në Turqi.

Autoriteti Rregullativ për Shërbime të Ujit vazhdoi t'i lironte nga pagesa e shërbimeve për ujë ndërtesat fetare që u përkasin pesë bashkësive fetare "tradicionale", në pajtim me ligjin. Si viteve të kaluara, agjencia nuk e liroi nga pagesa bashkësinë protestante, pa asnjë sqarim.

BIK-u raportoi për incidente të diskriminimit në punësim kundër myslimanëve të devotshëm, posaçërisht në sektorin arsimor.

Më 29 korrik, kandidati për kryetar komune i partisë nacionaliste Vetëvendosje (VV), Fisnik Korenica, postoi në Facebook se Izraeli së shpejti do të "zhduket nga faqja e dheut", si reagim ndaj incidenteve në Jerusalem. Pas kritikave nga vendorët dhe ndërkombëtarët, përfshirë Presidentin Hashim Thaçi, këshilltarin e Kryeministrit, Halil Matoshi, dhe kryetarin e VV-së Visar Ymeri, ai e fshiu postimin dhe kërkoi falje.

Përkundër një vendimi të shpallur nga Presidenti në nëntor të vitit 2016 për ndalimin e shitjes dhe shpërndarjes së librave anti-semitikë, në fund të vitit qeveria nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim administrativ për ta zbatuar vendimin.

Ministria e Punëve të Jashtme e anuloi Konferencën Ndërkombëtare Ndërfetare 2017 në favor të një ngjarjeje më të madhe në vitin 2018 për të përkuar me 10-vjetorin e pavarësisë së vendit. Konferenca e fundit ndërfetare u mbajt në vitin 2016.

Më 5 shtator, zyrtarë të lartë qeveritarë dhe përfaqësues nga bashkësitë kryesore fetare morën pjesë në shenjtërimin e Katedrales Katolike Shën Tereza në Prishtinë. Presidenti Thaçi e quajti katedralen simbol të tolerancës fetare.

Në një shembull të angazhimit të qeverisë me grupet fetare, në janar Forca e Sigurisë e Kosovës (FSK) i dhuroi shtroja Kishës Ortodokse Serbe për t'ua shpërndarë familjeve lokale në nevojë. FSK-ja premtoi se një mbështetje e tillë, pavarësisht nga feja dhe përkatësia etnike

e përfituesve, do të vazhdojë. Në mars, OJQ Beit Izrael, në partneritet me FSK-në dhe Ndërmarrjen Publike Hortikultura, i pastroi varret në varrezat hebraike në Prishtinë.

Seksioni III. Statusi i respektit shoqëror për lirinë fetare

Pati raste të dhunës mbi baza fetare, të ndërhyrjes në pelegrinazhe fetare, të fjalimit urrejtës dhe vandalizmit. Pasi feja dhe përkatësia etnike shpesh janë të lidhura ngushtë, kategorizimi i shumë incidenteve si incidente të bazuara në identitet fetar është i vështirë.

Më 6 janar (nata e krishtlindjes ortodokse), dhjetëra aktivistë të VV-së protestuan kundër vizitës së pelegrinëve serbë në kishën ortodokse serbe në Gjakovë, duke pohuar që ka kriminelë lufte në këtë grup. Protestuesit hodhën gurë dhe ngjyrë të kuqe në autobusin e vizitorëve, duke dëmtuar një dritare, dhe shkruan me ngjyrë fjalën “vrasës” në murin e jashtëm të kishës. Policia i shpërndau protestuesit dhe i arrestoi shtatë prej tyre për mosrespektim të urdhrave të policisë dhe vandalizëm. Policia më vonë i liroi të shtatët. Pelegrinët morën pjesë në shërbime dhe u larguan të sigurt. Kryetarja e Gjakovës Mimoza Kusari-Lila lëshoi një deklaratë publike për lirinë e lëvizjes, të drejtën për të protestuar publikisht dhe për drejtësi për viktimat e krimeve të luftës dhe jo për dhunë. Ministri për Komunitete dhe Kthime, Dalibor Jevtiq, gjithashtu e dënoi dhunën. Përfaqësuesit e VV-së thanë se pelegrinazhi ishte provokim dhe kërkuan drejtësi për familjet e viktimave të luftës.

Në qershor, së paku 100 myslimanë u tubuan afër vendit të xhamisë së propozuar në Mitrovicë për ta festuar Eid al Fitr, përfshirë kryetarin e Mitrovicës jugore, Agim Bahtiri. Disa përfaqësues të serbëve thanë se e konsideruan ngjarjen si nxitje nga shqiptarët etnikë, ndërsa BIK e cilësoi atë si jopolitike. Më 4 gusht, rreth 20 persona kryesisht shqiptarë u tubuan përsëri në vendin e xhamisë për lutjet e së premtes. Policia ua mohoi një kërkesë për leje para tubimit, duke cituar mundësinë për përplasje midis serbëve dhe shqiptarëve. Tubimi vazhdoi pa leje. Policia mbikëqyri tubimin dhe nuk raportoi për incidente. Një tubim i ngjashëm u mbajt më 18 gusht.

Mediat raportuan se përfaqësuesit e bashkësisë Shia në vend u tubuan më 18 mars për t'i ndarë Tarikatet Shia nga BIK-u. BIK-u kundërshtoi përfshirjen e Tarikateve si subjekt i gjastë fetar në projektligjin për lirinë fetare, duke theksuar që BIK-u ishte përfaqësuesi i vetëm i bashkësisë islame në vend. Bashkësia e Tarikateve tha se do të vepronte në bazë të ligjit të vet, statutit dhe traditës së interpretimit paqësor dhe autentik të Islamit.

KOS-i i kritikoi mediat se i kontribuuan një klimë të jotolerancës. BIK-u tha se mediat në përgjithësi i portretizonin myslimanët në një dritë negative.

Gjatë vitit, policia raportoi për 44 incidente që synonin objektet fetare të incidenteve ku përfshiheshin dëmtimi i pronës, vjedhjet dhe grafitët. Këto synonin objektet e bashkësisë islame (21), kishës ortodokse serbe (20) dhe kishës katolike romake (3).

Më 18 janar, 15-20 anëtarë të “Demokracisë Studentore” (një grup i lidhur me VV-në), shfaqën fotografi të krimeve të supozuara të luftës të kryera nga ushtria serbe pranë kishës së papërfunduar Ortodokse Serbe të Krishtit Shpëtimtar në Prishtinë. Policia i pengoi t'i varnin fotografitë në muret e kishës. Protestuesit thanë se kisha do të funksiononte si “muze i krimeve të luftës të kryera nga kriminelët serbë”.

Më 14 shkurt, një grup prej 20 shqiptarësh kënduan parulla anti-serbe dhe ngjyrosën grafitë anti-serbë në një zonë serbe të Gjilanit, përfshirë kishën ortodokse serbe dhe muret e jashtme të një shkolle serbe. Në to ishte shkruar: “Vritni serbët”, një kryq i thyer, dhe “UÇK - Ushtria Çlirimtare e Kosovës”, e cila është e lidhur me nacionalizmin shqiptar.

Më 11 prill, Demokracia Studentore denoncoi “vepra klandestine” që thuhej u zhvilluan në Kishën e Krishtit Shpëtimtar në kampusin e Universitetit të Prishtinës. Grupi tha se një “grup i politizuar i serbëve, me mbështetjen e disa priftërinjve”, ishte “duke nxitur urrejtje kundër shqiptarëve nëpërmjet ndërtesës fetare të kishës ortodokse”. Grupi kërcënoi të protestonte nëse institucionet përgjegjëse nuk vepronin për ta parandaluar qasjen dhe ndërtimin në kishë. Një zëdhënës i komunës së Prishtinës tha se komuna i kishte ndaluar të gjitha aktivitetet e ndërtimit për shkak të dokumentacionit joadekuat.

Më 15 prill, policia arrestoi një serb për sulmin në një xhami në fshatin Llabjan, komuna e Novobërdës. Udhëheqësit serbë e dënuan sulmin.

Më 1 gusht, kundërshtarë të xhamisë shkruan grafitë në kompleksin e Universitetit të Prishtinës duke sulmuar Presidentin Hashim Thaçi, kryetarin e komunës Shpend Ahmeti dhe myftiun Naim Tërnavë. Në parulla thuhej: “Në Dardani s’do të ketë xhami turke” dhe “Vdekje (Myftiut të Madh) Naim Tërnavë dhe Hashim turkut”. Më 2 gusht, grafitë të tjerë u panë në dy xhami të tjera në Prishtinë, të dyja të restauruara përmes financimit turk. BIK-u dënoi mbishkrimet si fjalim urrejtës dhe u bëri thirrje studentëve që t’i shmangen dhunës ose shprehjeve të jotolerancës. Policia arrestoi një të dyshuar dhe hetoi të tjerët.

Udhëheqës të grupeve të ndryshme fetare raportuan për marrëdhënie në përgjithësi të mira me njëri-tjetrin dhe morën pjesë në diskutime të shumta ndërfaqetare për të drejtat pronësore, prioritetet legjislativë dhe çështje të bashkësive lokale. OSBE-ja vazhdoi t’i koordinonte disa aktivitete mes grupeve fetare, përfshirë takimin me kryetarë të komunave, për t’i diskutuar çështjet si qasja në varreza dhe lejet për të ndërtuar ndërtesa fetare.

Seksioni IV. Politika dhe angazhimi i Qeverisë Amerikane

Ambasadori dhe përfaqësues të Ambasadës së SHBA-së u takuan shpesh me zyrtarë qeveritarë, përfshirë Presidentin, Kryeministrin, kryetarin dhe anëtarë të Parlamentit, për ta nxitur miratimin e legjislativës që do t’u lejonte institucioneve fetare të funksiononin pa pengesa, dhe për ta mbështetur zbatimin e plotë të ligjit për ZVM-të. Zyrtarët e Ambasadës nxitën dialogun e shtuar mes anëtarëve shqiptarë të qeverisë dhe shoqërisë civile me anëtarë të KOS-it. Ambasada nxiti zyrtarët qeveritarë që ta zgjidhnin kontestin pronësor ku përfshihej Kisha e Shën Nikollës në manastirin e Shën Arkangjelit në Prizren dhe mospagesën e qirasë ndaj KOS-it për shfrytëzim të pronës nga AKK-ja në Prishtinë. Ambasada mbështeti në të gjitha nivelet zbatimin e vendimit të vitit 2016 të Gjykatës Kushtetuese në favor të Manastirit të Deçanit, duke nxitur qeverinë dhe gjyqësorin që t’i mbanin përgjegjës zyrtarët lokalë. Ambasada diskutoi çështjet pronësore të grupeve të tjera fetare me zyrtarë qeveritarë në shumë raste dhe i nxiti zyrtarët t’i zgjidhnin çështjet në bazë të ligjit.

Zyrtarë të Ambasadës rregullisht diskutuan tolerancën fetare me udhëheqësit e të gjitha grupeve të mëdha fetare. Ambasada shtroi një iftar ndërfaqetar në Prizren, gjatë të cilit diskutoi rëndësinë e luftimit të ekstremizmit të dhunshëm, zgjidhjen e kontesteve pronësore të KOS-it, sigurimin e hapësirës për varreza për të gjitha bashkësitë dhe ngritjen e rëndësisë së lirisë fetare në vend, përfshirë projektligjin për lirinë fetare. Zyrtarë të Ambasadës u takuan me

imamë të BIK-ut për t'i diskutuar përpjekjet për ta mbështetur tolerancën dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm, dhe diskutuan projektligjet për liri fetare dhe trashëgimi kulturore me udhëheqës fetarë. Zyrtarë të Ambasadës u takuan me udhëheqës fetarë në shumë raste për t'i diskutuar të drejtat e njeriut dhe shqetësimet e tyre ligjore. Ambasada shpesh postonte porosi në mediat sociale në mbështetje të lirisë fetare. Si përgjigje ndaj dhunës së shprehur nga aktivistët e VV-së kundër pelegrinëve ortodoksë serbë në janar, ambasadori shkroi në "Tweeter" se dhuna nuk kishte vend në protesta.

Një zyrtar vizitues i Departamentit të Shtetit u takua në mars me udhëheqësit e KPUK-ut, BIK-ut, KOS-it, Bashkësisë së Tarikateve të Kosovës dhe peshkopin e Kishës Katolike të Kosovës, si dhe me anëtarë të bashkësive bektashiane e hebraike për t'i diskutuar sfidat me të cilat ballafaqoheshin dhe shqetësimet e tyre lidhur me lirinë fetare. Zyrtari gjithashtu u takua me deputetë lidhur me projektligjin për lirinë fetare dhe me kryetarin e Gjakovës dhe nënkryetarin e komunës së Prishtinës për trajtimin e grupeve fetare, përfshirë hapësirën për varreza dhe lejet për ndërtimin e shtëpive të adhurimit. Zyrtari gjithashtu u takua me anëtarë të Fakultetit të Studimeve Islame dhe OJQ-të për ta diskutuar lirinë fetare në arsim dhe në vend.

Më 12 tetor, ambasadori vizitoi katedralen e sapo shenjtëruar të Shën Terezës në Prishtinë. Në fjalën e tij, Ambasadori ripohoi angazhimin e SHBA-së për mbrojtjen e lirisë fetare në vend.